

VENDIM
Nr.103, datë 28.3.2011

MBI MOSRINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT
VENDOR “RADIO LEZHA”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Sami Neza	anëtar
Gent Ibrahim	anëtar (në mungesë)
Zylyftar Bregu	anëtar

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës për rinovim licence të paraqitur nga subjekti radiofonik privat vendor “Radio Lezha”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 22, 25 dhe 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullorja “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, vendimi i KKRT-së nr.215, datë 20.12.2010 “Për shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Lezha”, ligji nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

VËREN SE:

KKRT-ja, me vendimin nr.296, datë 22.12.2004, ka licencuar subjektin, personin fizik z. Gjovalin Dushaj, për radion private vendore “Radio Lezha”. Me vendimin nr.701, datë 16.7.2008, KKRT-ja ka rinovuar licencën e këtij subjekti për një periudhë 3-vjeçare. Në përfundim të afatit të vlefshmërisë së licencës, subjekti radiofonik privat vendor ka depozituar në KKRT aplikimin përkatës për rinovimin e licencës.

Në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit tërësor të aplikimit nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, KKRT-ja me vendimin nr.215, datë 20.12.2010, vendosi paraprakisht mosrinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Lezha”, për arsyt e parashtuara në vendim.

Sipas pikës dy të vendimit, ky subjekt kishte të drejtë që brenda 30 ditëve të parashtronte pretendimet e tij lidhur me këtë vendim.

Me shkresën e datës 31.1.2011, subjekti radiofonik privat vendor “Radio Lezha”, përfaqësuar nga znj. Olta Paja, ka depozituar në KKRT, plotësimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës.

Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se është paraqitur një deklaratë mbi arsyen e shitjes së aktivitetit, deklaratat e pesë anëtarëve të bordit drejtues, fotokopje e kontratës së shitjes së radios “Lezha”, pasqyrat financiare të subjektit për vitin 2009, projekti teknik i firmosur në fletën e parë nga ing. Gjini Marku, fotokopje e NIPT-it dhe mandatpagesa për shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj KKRT-së.

Konkretisht, subjekti person fizik z.Gjovalin Dushaj, i licencuar nga KKRT-ja për radion “Lezha”, ka deklaruar arsyet e shitjes së aktivitetit, ndër të cilat theksohet pamundësia financiare për ta vazhduar më tej aktivitetin e kësaj radioje. Subjekti deklaroi se ka bërë ndryshimet e kërkuara nga ligji në organet tatimore.

Subjekti radiofonik privat vendor “Radio Lezha”, nuk ka respektuar nenin 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar, sipas të cilit subjektet janë të detyruara të njoftojnë KKRT-

në për çdo ndryshim të të dhënave që kanë paraqitur në kërkesën për marrje licence, jo me vonë se 15 ditë pas bërjes së këtyre ndryshimeve. Subjekti në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka tjetërsuar licencën e radios private vendore “Lezha”, dhe për këtë ndryshim nuk ka kërkuar miratimin e KKRT-së.

Gjithashtu, subjekti nuk ka depozituar kontratat individuale të punës, kapitali financiar rezulton me vlerë 186.861 lekë, vlerë, e cila nuk është në përputhje me kriterin e parashikuar në rregulloren “Kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr.355, pika 2, datë 29.8.2005 të KKRT-së.

Nga sa më sipër, rezulton se nuk mund të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Lezha”.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 22, 25 dhe nenit 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, vendimit nr.215, datë 20.12.2010 të KKRT-së dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të mos rinovojë licencën me nr. 060/FML, të subjektit radiofonik privat vendor “Radio Lezha”.
2. Licenca nr.060/FML bëhet e pavlefshme.
3. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati